



Prishtinë, 20 dhjetor 2018
Kodi i ZRRE-së: V_1078_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, neni 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 16 paragrafin 4 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V_870_2016 të datës 14 dhjetor 2016 për shoqërinë "Eurokos JH" SH.P.K. për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 3, në Lumin Brod ZK Vraniq dhe në rrjedhën e lumit Plavë, ZK Kukalane, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, komuna e Dragashit;
- Kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin Final V_870_2016 të datës 14 dhjetor 2016 edhe për një (1) vit, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 3, në Lumin Brod ZK Vraniq dhe në rrjedhën e lumit Plavë, ZK Kukalane, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, komuna e Dragashit, të datës 10.12.2018 nr. prot. 280/18 të shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K. me adresë: rr. "Migjeni" nr. 23, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës, dhe

në seancën e mbajtur me datë 20 dhjetor 2018 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** kërkesa e shoqërisë "Eurokos JH" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_870_2016 të datës 14 dhjetor 2016 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 3, në Lumin Brod ZK Vraniq dhe në rrjedhën e lumit Plavë, ZK Kukalane, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, komuna e Dragashit, edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 14 dhjetor 2019 për ndërtimin e Hidrocentralit HC Brodi 3, sipas Lejes së Ndërtimit 06 nr. 351-199966/16 të datës 21.10.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Dragashit.



Arsyetim

- ZRRE me datë 27.03.2015 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese nga UJI, në Lumin Brod, HC Brod 1 me kapacitet të instaluar prej 1.06 MW dhe HC Brod 3 me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW ZK Bord dhe ZK Kukalane, komuna e Dragashit, Republika e Kosovës.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji pas analizimit të dëshmimeve të prezantuara nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., në seancën e mbajtur me datë 28 janar 2016 ka vendosur se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Brodi 3, dhe ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nr. V_767_2016.
- Vendim mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar, nuk ka nënkuptuar edhe lëshimin e Autorizimit për Ndërtim, përderisa nuk plotësohen kërkesat e përcaktuara me Rregullën e Procedurës së Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja.
- ZRRE me datë 24.11.2016 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim FINAL për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga UJI në Lumin Brod, HC Brod 3 me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW ZK Bord dhe ZK Kukalane, komuna e Dragashit, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore dhe ujore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, Lejen Ndërtimore të lëshuar nga komuna dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në mbledhjen e mbajtur me datë 14 dhjetor 2016, pas vlerësimit dhe analizimit të kërkesave sipas aplikacionit dhe lejeve të lëshuara nga institucionet relevante, ka vendosur që shoqërisë “Eurokos JH” SH.P.K., ti lëshohet Vendimi për Autorizimin FINAL V_870_2016, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 3, në Lumin Brod ZK Vraniq dhe në rrjedhën e lumit Plavë, ZK Kukalane, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, komuna e Dragashit, sipas Lejes së Ndërtimit 06 nr. 351-199966/16 të datës 21.10.2016, të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit, Komuna e Dragashit.
- ZRRE me datë, 02.08.2018 nga shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., ka pranuar kërkesën për vazhdimin e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizimin FINAL V_870_2016 të datës 14 dhjetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali HC Brodi 3, ZK Vraniq dhe ZK Kukalane me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, **edhe për një (1) vit, gjegjësisht deri me 14 dhjetor 2019 për finalizimin e projektit.**
- Shoqëria “Eurokos JH” SH.P.K., në kërkesën e saj ka theksuar se: që nga data e pranimit të vendimit për Autorizim final të Bordit të ZRRE-së, kanë filluar përgatitjet për fillimin e punimeve në ndërtimin e Hidrocentralit HC Brodi 3, duke filluar me matjet gjeodezike nga expertët e fushës, hapja e rrugës, traseja e tubacionit dhe ndërtesa e hidrocentralit.



- Shoqëria "Eurokos JH"SH.P.K., në kërkesën e saj po ashtu ka sqaruar se, janë duke punuar intesivisht në teren edhe përkundër vështirësive në realizimin e projektit HC Brodi 3, ku deri më tani janë përfunduar pothuajse të gjitha punimet: hapja e trasesë për vendosjen e tubacionit është përfunduar, janë vendosur dhe montuar më shumë se 4 km tubacion, është përfunduar dhe finalizuar vepra e marrjes, është përfunduar ndërtesa e hidrocentralit, janë duke u montuar turbinat s' bashku me të gjitha pajisjet përcjellëse teknike dhe teknologjike, si dhe është në përfundim e sipër largpërçuesi, dhe nga kjo mund të iu sigurojmë se deri tani janë përfunduar më shumë se 90 % e punimeve.*
- *"Eurokos JH"SH.P.K., ka sqaruar gjithashtu se, arsyeja e parashtrimit të kërkesës për shtyrje të afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final, për ndërtimin e Hidrocentralit HC Brodi 3 është se, kemi pasur të bëjmë me një terren të vështirë, ku ka rrëshqitje të dheut, shirat e vazhdueshëm nga moti i papërshtatshëm për zhvillimin e punëve normale, në periudhën e vjeshtës dhe të pranverës, specifikave të terrenit dhe projektit i kanë detyruar që të kihet kujdes, pasi që vlera e projektit është mjaft e madhe dhe rreziqet është dashur të kihen parasysh, dhe të gjitha këto i kanë shkaktuar vonesa në përfundimin e këtij projekti deri më tani e për të cilën kërkohet të mundësohet shtyrja nga ZRRE-ja për finalizimin e projektit.*
 - *Andaj, bazuar në të gjitha ato që u paraqitën më lartë, shoqëria "Eurokos JH" SH.P.K., ka kërkuar nga Bordi i ZRRE-së, që duke u mbështetur në dispozitat ligjore të nenit 16 par. 4 të Rregullës për procedurën e Autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, t'iu lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit FINAL V_870_2016 të datës 14 dhjetor 2016, për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese nga hidrocentrali HC Brodi 3 edhe për një (1) vit, edhe pse jen të bindur se shumë shpejt HC Brodi 3 do të lëshohet në prodhim dhe fazë testuese, mirëpo për të qenë në harmoni me procedurat ligjore është kërkuar shtyrja më e gjatë, në mënyrë që të jen koherent me Procedurat e Autorizimit.*
 - *Bordi i ZRRE-së, pas analizimit të kërkesës së shoqërisë "Eurokos JH"SH.P.K., dhe dëshmime të bashkangjitura për shtyrje të afatit të vlefshmërisë të Autorizimit Final, për ndërtimin e kapaciteteve gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali HC Brodi 3, në Lumin Brod ZK Vraniq dhe në rrjedhën e lumit Plavë, ZK Kukalane, me kapacitet të instaluar prej 4.7 MW, komuna e Dragashit, ka vlerësuar ato, dhe ka konsideruar se arsyeshmëria e kërkesës së aplikuesit është e bazuar, dhe duke u mbështetur në shkresat e lëndës, ku janë prezantuar fakte se brenda kësaj periudhe do të finalizohet projekti, ka vendosur që të lejohet shtyrja e afatit të vlefshmërisë së Autorizimit Final V_870_2016 i datës 14 dhjetor 2016, edhe për një afat shtesë ligjor, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi.*
- II. Vendimi për Lëshimin e Autorizim Final V_870_2016 i datës 14 dhjetor 2016, do të vlen deri me datë **14 dhjetor 2019**, sipas dispozitivin nën pikën I., të këtij vendimi, në rast se nuk arrin të përfundoj ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese nga Uji, apo nuk vepron në pajtim me legjislacionin në fuqi, vendimi do të shfuqizohet.
- III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. Kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Dragashit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së,dhe
- Arkivit të ZRRE-së